

SHQETËSIMET DHE ANKESAT



Nëse vëreni se DRC nuk i përmbush standardet dhe angazhimet e saja, ne shpresojmë që ju do të na njoftoni lidhur me këtë. Ju mund ta bëni këtë duke shprehur shqetësimin tuaj në mënyrë jo formale tek stafi jonë ose duke përdorur mekanizmat tonë zyrtar të ankesave.

KUSH MUND TË ANKOHET?

- Personat që marrin pjesë në operacionet e DRC-së
- Personat e tjerë të ndikuar drejtpërdrejt nga veprimet dhe politikat e DRC
- Partnerët humanitar, kontraktuesit dhe autoritetet
- Stafi i DRC-së

Nëse keni ndonjë koment apo shqetësim joformal në lidhje me punën tonë, ju lutemi të flisni drejtpërdrejt me stafin tonë. Nëse shqetësimi i juaj nuk zgjidhet, atëherë ju duhet të parashtroni një ankesë zyrtare. Mekanizmi për parashtrimin e ankesave zyrtare është i ndryshëm për ankesat e ndjeshme dhe ato operacionale.

ANKESAT E NDJESHME

zbatohen për shkeljet e rënda të Kodit të Mirësjelljes së DRC-së, të cilat shkelje, nëse vërtetohen, mund të çojnë në sanksione ndaj stafit apo partnerëve tanë. Shembujt përfshijnë: ryshfetin, shfrytëzimin dhe keqtrajtimin seksual, mashtrimin, korrupsionin, vjedhjen etj.

Dërgoni një e-mail në coc@drc-kosovo.org

OSE

Përdorni kutitë tona për ankesa:

Zyra Kryesore Prishtinë: Zyra në Mitrovicën Jugore:
Rr. Mark Isaku 30 Rr. Shemsi Ahmeti 99

Zyra në Prizren:
Rr. 178-Behajdin Hallaqi,1

OSE

Flisni drejtpërdrejt me stafin e DRC-së

Nëse besoni se zyra jonë vendore nuk mundet, ose nuk duhet të trajtojë raportin tuaj, ju mund ta dorëzoni atë direkt në zyrën qendrore ndërkombëtare në Kopenhagë:

Dërgoni një e-mail në c.o.conduct@drc.dk

ANKESAT OPERACIONALE

kanë të bëjnë me çështjet operacionale, të tilla si administrimi i kritereve të përzgjedhjes të DRC-së si dhe cilësinë dhe sasinë e ndihmës së ofruar nga DRC.

Flisni drejtpërdrejt me stafin e DRC-së

OSE

Përdorni kutitë tona për ankesa:

Zyra Kryesore Prishtinë: Zyra në Mitrovicën Jugore:
Rr. Mark Isaku 30 Rr. Shemsi Ahmeti 99

Zyra në Prizren:
Rr. 178-Behajdin Hallaqi,1

OSE

Dërgoni një e-mail në complaints@drc-kosovo.org

POLITIKAT E PAANSHMËRISË DHE KONFIDENCIALITETIT

Raportet e dorëzuara janë konfidenciale.

DRC do të sigurojë që ankesat të trajtohen në mënyrë profesionale dhe të drejtë, duke respektuar integritetin e personave të përfshirë.

DRC nuk do të toleroj asnjë përpjekje të stafit të DRC-së për të frikësuar ose hakmarrë ndaj ndonjë ankuesi.